- Kam marrë pjesë në takimin e organizuar nga ME, takimi është organizuar me qëllim të diskutimit të raporteve të dërguara në kuadër të rishikimit të Programit Kombëtar për Integrim Evropian. Takimi është mbajtur më datën 21.10.2025 në ME.
- Kam marrë pjesë në takimin e organizuar nga ME, takimi është organizuar me qëllim të diskutimit të të dhënave të paraqitura nga institucionet lidhur me projektet e paraqitura në "Procesin e rishikimit të Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2026–2028". Takimi është mbajtur me datë 29.10.2025 në ME;
- Kam qenë e angazhuar në grumbullimin e të dhënave dhe përgaditjen e Draft Bilancit vjetor të energjisë termike 2026, etj.;
- Kam marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga ME më datë 12.11.2025. Punëtorja është organizuar me rastin e lansimit të Manualit për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031, si dhe për programet implementuese tre-vjeçare;
- Kam marrë pjesë në punëtorinë e organizuar për FOPIP EŠAP më datë 12.11.2025;
- Kam marrë pjesë në takimin e mbajtur në mes "Termokos" dhe ZRRE, për të diskutuar çështjen e dokumentacionit të kërkuar nga ZRRE për procedurën e vazhdimin të licencës së prodhimit të ngrohjes qendrore me mazut. Takimi është mbajtur në ZRRE me datën 22.12.2025.

## Inspektimi, mbrojtja dhe siguria në punë

Në kuadër të mbikëqyrjes/ inspektimit të aktiviteteve të mbrojtjes dhe sigurisë në punë dhe MKZ-së, gjatë periudhës raportuese tetor-dhjetor 2025, janë realizuar këto aktivitete:

- Kujdesi për mbrojtjen dhe sigurinë në punë të personelit, duke bërë kontrolla të vazhdueshme, se a po përdoren rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë. Po ashtu, bëhen edhe inspektime në vendpunishte për të parë nga afër se a po punohet me standarde dhe në pajtueshmëri me Ligjin 04/L-161;
- Është mbajtur evidencë e saktë e mjeteve mbrojtëse në punë, pajisjeve kundër zjarrit dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin, është inspektuar zbatimi i masave për mbrojtjen në punë;
- Në bashkëpunim me mirëmbajtësit e oborrit të "Termokos" SH.A. jemi kujdesur për hapësirat gjelbëruese si dhe mirëmbajtjen dhe pastrimin e të gjithë hapsirës;
- Janë bërë kontrole të vazhdueshme për ndalimin e pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura, ku dhe janë shqiptuar vërejtje gojore për punëtorët, të cilët nuk i janë përmbytur ndalesës për pirje të duhanit;
- Angazhimi në cilësinë e projekt menaxherit për furnizim me rroba dhe këpucë pune për stafin e NP "Termokos". Projekt menaxher për sigurimin e objekteve dhe pajisjeve.
- Angazhimi në cilësinë e kryetarit të Komisionit për shitjen e skrapit.

## Divizioni i sigurimit

- Gjatë periudhës raportuese TM4/2025, Divizioni i sigurimit ka kryer punët dhe detyrat sipas përgjegjësisë që kanë, si në NP "Termokos" Sh.A., ashtu edhe në ngrohoren tek spitali. Janë evidentuar hyrje-daljet e personelit me automjete, gjithashtu janë përcjellur evidentimet, hyrje- daljet e punëtorëve, janë inspektuar çdo material, që ka hyrë dhe ka dalë nga "Termokosi", njëkohësisht jemi marrë edhe me konsumatorë, të cilët kanë pasur nevojë për ndihmë duke i drejtuar tek personeli i "Termokos"-it dhe tek drejtorja.

- Në vazhdimësi me punën rutinë që kanë sigurimi ka bërë sigurimin fizik të hapësirave në Termokos .
- Janë përcjellur kamerat në vazhdimësi për ndonjë problem eventual, kanosje, vjedhje etj.


# Investimi më i madh në Kosovë në sistemin e ngrohjes qendrore, që nga vitet e '70-ta

Në kuader të përmirësimit të sistemit të ngrohjes qendrore, janë investuar mbi **Eur 37.1 mil.** Financimi i Projektit të kogjenerimit është bërë nga Bashkimi Evropian Eur 13.8mil, Qeveria Gjermane & KfW Eur 15.0 mil., Qeveria e Luksemburgut Eur 1.5 mil., Qeveria e Suedisë Eur 1.9 mil., Qeveria e Kosovës Eur 1.2 mil dhe Komuna e Prishtinës Eur 3.8mil.

## PRODHIMI I ENERGISË TERMIKE

# Skema e funksionimit të sistemit të kogjenerimit

Figura 2. Skema e funksionimit të sistemit të kogjenerimit





## DEPARTAMENTI I PRODHIMIT

### RAPORTI I PUNËVE TË REALIZUARA SIPAS PLANIT AKSIONAL 2025 TË PRODHIM/KOGJENERIMIT

#### Divizioni i makinerisë

Në vijim në mënyrë të përmblëdhur i paraqesim aktivitetet, të cilat janë realizuar në muajin tetor- dhjetor 2025, nga DP/kogjenerimit:

Gjatë periudhës tetor- dhjetor 2025, DP/kogjenerimi ka realizuar aktivitetet kryesore operative dhe mirëmbajtëse për përgatitjen dhe funksionimin stabil të sistemit të ngrohjes.

- Realizimi i planit aksional 2025 nga Divizioni i makinerisë;
- Përgatitja teknike dhe fillimi i furnizimit me ngrohje për QKUK-në (03–08.10.2025);
- Fillimi i marrjes së avullit nga blloku B1 nga data 07.10.2025;
- Mbushja e rrjetit me ujë të përgatitur dhe mirëmbajtja e stabilimenteve termoenergjetike;
- Pastrim filtrash, lubrifikim pompash, matje temperaturash dhe eliminim rrjedhjesh;
- Lëshimi në punë i pajisjes së degazifikimit dhe mbushja e rezervuarëve heat storage;
- Janë evidentuar ndërprerjet e energjisë elektrike nga KEDS-i dhe kufizimet në marrjen e energjisë termike nga KEK-u;
- Operim i pajisjes së degasifikimit në rrjetin e distribuimit;
- Mirëmbajtje e vazhdueshme e stabilimenteve, pastrim filtrash dhe çajrosje e rrjetit;
- Për shkak të ngarkesës më të ulët termike, operim fillimisht me dy këmbyses;
- Me rritjen e kërkesës termike, në fund të muajit është aktivizuar edhe këmbyesi i tretë, me dy pompa të kogjenerimit dhe katër pompa të distribuimit;
- Ndërprerje të energjisë elektrike nga KEDS-i, të raportuara zyrtarisht nga KEK-u.
- Futje e ujit nga zbutësit e kogjenerimit në rezervuarin ditor;
- Mirëmbajtje e stabilimenteve dhe lubrifikim i pompave në NQ, HRS, HES dhe BD;
- Pastrim filtrash, matje temperaturash dhe largim uji nga puseta problematike;
- Operim me një bllok (B2) në disa ditë për shkak të daljes jashtë pune të B1, me kufizim të ënergjisë termike deri në 70 MWh;
- Ndërprerje të energjisë elektrike dhe incidente në komunikimin SCADA;
- Inspektim i trasës së kogjenerimit dhe njoftim i OE për sanim izolimi në pikat në garancion;
- Me datë 15.12.2025, me kërkesë të Divizionit të elektrikës dhe në koordinim me zyrtarët e KEK-ut, për shkak të testimit të kabllit furnizues, është ndërprerë furnizimi me avull nga KEK-u, në intervalin kohor 15:00–16:00;
- Gjatë inspektimit të trasës së kogjenerimit, me datë 17.12.2025, është vërejtur dalje e avullit në pozicionet P62, P64/64 dhe P95, në zonat ku janë të instaluar gypat e ngrohjes. Dëshohet për depërtim të ujërave nëntokësore në këto tri pika; Në pikën P62, ku ndërhyrja është realizuar nga OE "Allzone" dhe është ende në periudhë garancioni, në cilësinë e menaxherit të kontratës për projektin "Riparimi i izolimit të gypave të kogjenerimit", kam njoftuar operatorin ekonomik për sanimin e izolimit në pjesën ku janë zhvilluar punimet, në përputhje me obligimet kontraktuale.




Ditët e shkallëve të ngrohjes dhe temperaturat mesatare mujore

**Tabela 12.** Gradët ditore në TM4/2025

Muajt	GD - Gradë ditore	Temp. mesatare mujore, °C,	Ditët e punës
Tetor	122	12.3	24
Nëntor	324	9.2	30
Dhjetor	494	4.1	31
<b>Totali</b>	<b>940</b>	<b>8.5</b>	<b>85</b>

**Figura 3.** Gradët ditore (GD) dhe temperaturat mesatare mujore gjatë periudhës raportuese TM4/2025,



Ky grafik paraqet gradët ditore dhe temperaturat për tremujorin tetor- dhjetor 2025:



- Shtyllat blu tregojnë gradët gitore (GD) për çdo muaj;
- Vija e kuqe tregon temperaturën mesatare mujore (°C).

Nga grafiku i lartëparaqitur duket qartë se:

- Temperaturat bien nga tetori në dhjetor, duke reflektuar fillimin dhe intensifikimin e sezonit të ngrohjes;
- Gradët ditore rriten proporcionalisht me rënien e temperaturës, që tregon rritjen e nevojës për ngrohje.



Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025 (tetor- dhjetor 2025), Departamenti i prodhimit/kogjenerimit ka dokumentuar vizualisht aktivitetet kryesore përmes fotografive, të cilat ilustronjë punët dhe proceset e kryera në këtë periudhë.

Data	Përshkrimi i punës me foto	Përshkrim i shkurtër i punës
09.10.2025		Është bërë kyçja e objektit të ri administrativ në sistemin e ngrohjes me valvula DN50mm.
15.10.2025		Për shkak të përzierjes së masës nga pjesa sekondare në atë primare në këmbyesin 3 në stacionin HRS, kemi ndërtuar një vijë me gypa të galvanizuar për kthimin e masës së përzier në rezervuarin ditor.
21- 22.10.2025		Intervenim në eliminimin e rrjedhjeve në gypat e kaldajës K2 në NS, ku janë blinduar 8 gypa.



Data	Përshkrimi i punës me foto	Përshkrim i shkurtër i punës
Nëntor 2025		Pastrim i filterave në stacionin BD dhe në NQ.
Dhjetor 2025		Pastrim i filterave në stacionin BD dhe në NQ, sipas nevojës.
06.12.2025		Intervenim në eliminimin e rrjedhjes së paraqitur në K2 në NS.

## BILANCI I ENERGJISË TERMIKE

### PODHIMI BRUTO DHE NETO I ENERGJISË TERMIKE, ENERGJIA E LIFERUAR DHE HUMBJET

Tabela 13. Bilanci i energjisë termike në TM4/2025

Total bruto prodhimi tetor- dhjetor 2025		143,585MWh			
<b>Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike sipas muajve</b>					
	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTAL	
Prodhimi bruto në stabilimentet prodhuese në ngrohore	0	0	0	0	
Bruto prodhimi në stabilimentet e kogjenerimit	30,483	48,364	64,738	143,585	
<b>Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWth)</b>	<b>30,483</b>	<b>48,364</b>	<b>64,738</b>	<b>143,585</b>	
Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogj.)	610	967	1,295	2,872	
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	2%	2%	2%	2%	
Konsumi vetanak (MWh)	64.43	72.24	143.35	280.02	
<b>Neto prodhimi i energjisë termike (MWh)</b>	<b>29,809</b>	<b>47,324</b>	<b>63,300</b>	<b>140,433</b>	
<b>Energjia e liferuar -MWh</b>					
Energjia termike e liferuar tek konsumatorët	-	-	-	-	
<b>Humbjet në rrjetin e shpërndarjes</b>					
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	-	-	-	-	
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	-	-	-	-	
<b>TOTAL HUMBJET</b>					
Total humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes					- MWh
Total humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes					-%

Shënim: Mungon raporti mbi energjinë e liferuar dhe humbjet e energjisë termike në rrjetin e distribuimit!

Figura 4. Energjia e prodhuar, e liferuar dhe humbjet MWh në tetor - dhjetor 2025





Figura 5. Humbjet në rrjetin e transmisionit dhe në rrjetin e shpërndarjes gjatë periudhës tetor-dhjetor 2025






## RAPORTI I PUNËVE TË REALIZUARA SIPAS PLANIT AKSIONAL 2025 TË PRODHIM/KOGJENERIMIT

### Divizioni i elektrikës

*Tabela 14. Aktivitetet e Divizionit të elektrikës gjatë periudhës raportuese tetor-dhjetor 2025*

Nr.	Përshkrimi	Data	Vërejtje
1	Pastrimi i të gjitha PC-ve në dhomën e kontrollit dhe punët tjera në pultin komandues; Serverët në pultin komandues; PC-ja për stacionin "Bregu i Diellit" e vendosur në pultin komandues; PC-ja për ES klient; Pastrimi i pajisjeve elektronike në pultin komandues; Rregullimi dhe përforcimi i përçuesve në kanale; Ndërrimi i butonëve të dëmtuar; Kompletimi me llamba për sinjalizim;	13.10.2025	Është përfunduar puna me pastrimin dhe kontrollimin e gjitha PC-ve dhe pajisjeve përcjellëse në dhomën e kontrollit
2	Përpilimi i kërkesës dhe pastaj instalimi i switch-it për selektim të PC-ve dhe monitorit mes displayport dhe HDMI	10/2025	Për shkak të vonesave në tenderim, gjithashtu edhe ritenderimit, ende nuk kemi në dispozicion pajisjen
3	Inverteri VFD i pompës së distribuimit 62P1: Është bërë planifikimi i buxhetit për ndërrimin e inverterit në fjalë, i vjetër më shumë se 20 vjet	14.11.2025	Në datën 03.11 ka filluar punën OE BF Energy në instalimin e inverterit të ri VFD, e cila ndërlihet me pompën qarkulluese 62P1 dhe në datën 14.11 është vënë në punë. Në datën 18.11 ora 23:05 kemi pasë problem me inverterin prandaj edhe në datën 19.11 prezent ishte OE BF Energy në lidhje me problemin, mirëpo pa sukses në funksionalizimin e inverterit. Në datën 20.11 kam informuar OE edhe përmes email-it dhe në datën 26.11.2025 OE ka ndërruar shndërruesin 220VAC/24VDC, njëkohësisht edhe kemi startuar me inverterin VFD. Fillimisht është startuar me kapacitetin 70%, ndërsa në datën 27.11.2025 është ngritur kapaciteti i pompës në 90% dhe vazhdojmë të punojmë me këtë pompë.
4	Kontrollimi, testimi dhe nëse është e domosdoshme edhe ndërrimi i baterive të UPS-it, i cili furnizon komplet panelin komandues të sistemit automatik të kontrollit në HRS	08.10.2025	Fillimisht ishte kontrolluar UPS-i i cili ishte dëmtuar dhe bateritë të cilat ishin të shpenzuara. Pastaj provuam përmes një servisi të jashtëm, mirëpo vetëm pas porositjes së baterive nga vetë ne si division dhe intervenimit në UPS kemi vënë në funksion UPS-in.
5	Pas përfundimit të punëve dhe përfundimit të projektit për zgjerim, planifikojmë upload-in e programeve nga PLC-të, të cilat janë në operim brenda në NQ: PLC Siemens – CPU 414-5H në NQ;	10/2025	Për shkak të vonesave të konsiderueshme të kontraktorit Ergotem, ende nuk kemi verzionin final të softuerit të PLC-së dhe SCADA
<b>Nënstacioni "HES "</b>			
6	Pajisjet për matjen e nivelit: Testimi i pajisjeve të nivelit, pastrimi i tyre nga mbeturinat dhe ndërrimi i tyre në rastet e nevojshme. Kontrollimi i kabllove të sinjaleve komanduese, nga pajisjet deri në panelin kryesor të sinjaleve;	01.10.2025	Janë testuar dhe kontrolluar pajisjet për matjen e nivelit dhe kontrollimi i sinjaleve komanduese
7	Kontrollimi dhe testimi kalkulatorit të energjisë në stacionin HES	13.10.2025	Është kontrolluar dhe testuar kalkulatori i energjisë
8	Testimi dhe në rastin e nevojshëm vendosja e baterisë për transmetimin e instrumentit të rrjedhjes në dy linjat e ngrohjes	13.10.2025	Janë kontrolluar dhe testuar dy instrumentet e rrjedhjes





Në datën 03.10.2025 kemi intervenuar në startimin e pompës qarkulluese në ngrohtoren e spitalit dhe në ora 11:20 kemi startuar me kalldajën 1, me të cilën fillimisht kemi punuar vetëm gjysmë ore dhe pastaj është startuar sipas marrëveshjes me QKUK-në. Kemi intervenuar në instrumentin e rrjedhjes së ujit tek zbutësat e distribuimit dhe mbetet në rregull.

Me 06 Tetor kemi takuar me koordinatoren për rrjetin në KEDS dhe është diskutuar rreth mundësisë për shfrytëzimin e trasesë së KEDS-it për shtrirjen e kabllor nga stacioni "Prishtina 6" deri në "NP. Termokos". Kemi bërë kërkesën për zgjidhje teknike në KEDS dhe në datën 17.10.2025 kemi pranuar zgjidhje teknike dhe zgjidhja teknike e tyre kërkon kosto të lartë financiare. Në datën 23.10 kemi pas takim me menagjmentin e KEDS-it në lidhje me shqyrtimin e mundësive të bashkëpunimit në ndërrimin e sistemit të shpërndarjes elektroenergjetike, të cilët brenda mundësive të veta kanë shprehur gadishmëri për të na ndihmuar. Në datën 24.10.2025 jam takuar me inxhinierin projektues nga KEDS-i Fatmir Jashari, nga i cili detajisht kemi shikuar pjesën e trasesë së KEDS-it që mund të shfrytëzohet nga ana jonë. Meqenëse nga menagjmenti i NP. Termokos është kërkuar që të shikohen mundësitë e zgjidhjes për trasenë përmes komunës së Prishtinës, është bërë kërkesë në Kuvendin komunal për ndihmë eventuale. Pas informimit nga ana e komunës për mosposedimin e kanaleve kabllorike në datën 08 Dhjetor dhe pamundësisë nga ana e tyre për të na ndihmuar, ne kemi vazhduar punën për mundësitë e ofruara nga KEDS-i. Prandaj në datën 11.12.2025, në KEDS është dorëzuar "Kërkesë për dislokim të kabllor 10kV/20kV" dhe jemi në pritje të përgjigjes teknike për kërkesën në fjalë, për të vazhduar tutje me pëlqimin në komunën e Prishtinës për punët që duhet të bëhen. Është bërë pagesa për sjelljen e kamionit të KEDS-it dhe testimin e kabllit 10kV "A" dhe në datën 07 Tetor në ndërmarje kanë ardhur punëtorët nga KEDS me kamionin për testimin e kabllit 10kV "A", e cila sipas matjeve të tyre rezultojt të jetë në rregull. Me rekomandimin e koordinatorit të KEDS-it, fillimisht kabllin "A" e kemi lërë të palidhur në nënstacionin Prishtina VI dhe sipas tij më mirë është të mbetet ashtu dhe të lidhet vetëm nëse kemi problem me kabllin "B", për shkak se në rast të ndonjë problemi kabllot bartin problemin tek njëra tjetra.

Në datën 07 Tetor kemi pas ndërperje të energjisë elektrike nga furnizimi kryesor dhe kjo ka ndikuar për një problem në Serverin 2 e cila alarmonte të ketë problem me disqet e instaluara, mirëpo fatmirësisht pas hapjes të serverit kemi rregulluar atë. Në të njëjtën ditë, problem kishim edhe në stacionin HES, me çrast pas fillimit të marrjes së energjisë kalkulimi ishte 100% më i lartë se ai real dhe nëse vazhdohej ashtu do të kishte edhe dëmtim financiar për ndërmarjen NP. Termokos, mirëpo kemi rregulluar edhe problemin në fjalë.

Në datën 08 Tetor kemi pasur ndërprerje pa paralajmërim të energjisë elektrike nga KEDS, duke qenë në situatë të vështirë për shkak të fillimit të sezonës ngrohëse dhe rrezikut për dëmtimin e pajisjeve, për të cilën fakt gjatë gjithë kohës kemi qenë në kontakt me kordinatoren në KEDS. Ndërprerja e energjisë elektrike ka qenë nga ora 10:00 – 10:10, 10:15 – 10:45 dhe 13:55 – 15:27.

Kemi bërë inspektimin e njehsorit DPR 90007098 me nr. të njehsorit 63892557 në të cilën ilegalisht e kishin larguar kabllon e ndërmarjes dhe në njehsorin e NP. Termokos kishin lidhur një kablo tjetër duke shkatruar edhe bllobën e njehsorit. Kemi bërë proces verbal dhe ndërkohë nga dikush sërish ishte lidhur kabloja e NP. Termokos.

Është pastruar puseta e kabllit 10kV nga gurët dhe përmes email-it për OE kemi kërkuar kujdes të shtuar gjatë punëve që do të bëhen në zonën afër pusetës.

Kemi bërë shtrirjen e kabllit për barakën e cila do të shfrytëzohet përkohësisht nga faturimi dhe pastaj kemi bërë edhe lidhjen elektrike të saj.

Kemi instaluar dy reflektor në ngrohtoren e spitalit, pas prishjes së katër reflektorëve të vendosur nga ana e NPB-së.

Kemi bërë një intervenim për mundësinë më të lehtë të resetimit në pajisjen e ndërprerësit të shtypjes në HES.

Pas ardhjes së kontajnerit të ri në stacionin HES, kemi çkyqyr furnizimin me energji elektrike nga kontajneri i vjetër dhe pastaj kemi bërë lidhjen në kontajnerin e ri.

Në datën 09 Nëntor, në qendër në distribuim është verifikuar se një pompë ishte djegur.

Është ndarë një pjesë e ndriçimit në dhomën e kontrollit përmes një ndërprerësi të veçantë.

Është asistuar nga tekniku i prodhimit në një stacion në distribuimit tek fakulteti teknik.

Në datën 12 Nëntor, nga ora 06:00 – 06:30 kishte ndërprerje pa paralajmërim të energjisë elektrike dhe pastaj rikyçja e sistemit në punë ishte pa probleme. Pas ndaljes pa paralajmërim të energjisë elektrike dhe kërcënimit të marr nga KEK-u, me email kemi adresuar shqetësimin tonë në KEDS.

Në datën 12.11.2025 dhe 13.11.2025 kam qenë në punëtorinë e organizuar nga FOPIP në Sirius.

Në datën 17.11 në ndërrimin e dytë, në ora 04:45 ka pas luhatje të tensionit me çrast është ndalur pompa e kogjenerimit 122P001 dhe pompat qarkulluese 62P4, 62P5. Meqenëse nuk janë ndalur dy pompat tjera qarkulluese, 62P1 dhe 62P2, atëherë sistemi ka startuar brenda 5 min dhe nuk ka afektuar në KEK.

Në datën 19 Nëntor, në ora 14:25 kemi pas oscilim të tensionit prandaj edhe janë çkyqyr nga furnizimi të gjitha pompat, përfshirë ato të

Në nëntor të vitit 2025, nga kompania "Ergotem" është vënë në funksion sistemi i dozimit në modin manual dhe është bërë zgjidhje rreth problemit të startimit të filtrit magnetik nga SCADA. Pastaj është bërë instalimi i analizatorit të PH-së dhe duket se vlerat e analizatorit janë të sakta.

Nga datat 01.12.2025- 04.12.2025 është kyçur nga distanca (remotely) nënkontraktori Powertronik, i angazhuar nga "Ergotem" për funksionalizimin e sistemit të dozimit në modin automatik dhe njëkohësisht edhe për përkthimin e SCADA në gjuhën shqipe. Gjatë gjithë kohës kam qenë i angazhuar për të asistuar në punët e lartpërmendura.

Në datën 16 dhjetor prezent në ndërmarje ishte drejtori i kompanisë "Ergotem", i cili kishte angazhuar sërish kompaninë laboratorike për të marr mostra në hyrje dhe dalje të sistemit të degazifikimit në distribuim. Analizat janë larg pritshmërive dhe nuk kemi ndonjë përgjigje se si do të veprohet. Ndërsa i njëjti ka dorëzuar AS-built-in e mbetur, të cilën njëkohësisht e kemi arkivuar dhe kopjen e kemi marr për interes të prodhimit.

Kemi qenë në kontakt me KEDS-in për arsyen e ndaljes së energjisë elektrike në stacionin CE28 në distribuim dhe arsye ishte mosprezenca e njehsorit në listën për pagesë, prandaj pas bisedës me KEK-un dhe KEDS-in kemi bërë validimin e njehsorit në fjalë.

Si Department i prodhimit ishim në takim me personat udhëheqës të "Kosovoa B" në KEK, për të diskutuar në lidhje me energjinë termike dhe ndikimi në KEK i ndërprerjeve pa paralajmërim të energjisë elektrike në NP "Termokos".

Në datën 04 dhjetor, nga ora 09:10- 09:35 është ndalur energjia elektrike dhe sipas punëtorëve të KEDS-it problemi ishte me kablalin kryesor "B" të furnizimit me tensionin e mesëm 10kV i cili është dëmtuar, prandaj edhe kemi kaluar në furnizimin me kablalin "A". Shpejtë kemi reaguar duke bërë pagesën për angazhimin e kamionit testues të KEDS-it, ndërsa në datën 05 dhjetor është bërë identifikimi i pozicionit të dëmtimit të kablilit nga ana e KEDS-it. Përmes email-it kam informuar komisionin e angazhuar për ndërtimin e ndërtesës së administratës dhe të njëjtit kanë informuar kompaninë "Limit" për të intervenuar në kablalin e dëmtuar nga ana e tyre disa muaj më herët dhe shfaqur problemet tani. Përveç saj, kam dërguar email në KEDS dhe është kërkuar për mundësinë e rregullimit të kablilit nga ana e tyre të cilët janë përgjigjur pozitivisht. Për t'a plotësuar kërkesën e punëtorëve të KEDS-it dhe mundësinë, që të intervenohet në kablalin e dëmtuar, në datën 12 dhe 13 dhjetor kemi bërë prerjen e gypit të trashë, që ishte mbi kablilot e tensionit 10kV dhe kemi krijuar kushtet që të intervenohet nga ana e KEDS-it. Prandaj në datën 13 dhjetor është rregulluar kabllin dhe në datën 15 dhjetor është bërë testimi i kablilit "B" të tensionit 10kV nga KEDS-i. Më tej, kemi ndërprerë furnizimin e energjisë elektrike në ndërmarje, kemi bërë fazimin e kablilit "B", kemi rikthyer furnizimin e energjisë elektrike dhe tani në ngarkesë kemi kablalin "A" dhe rezervë kemi kablalin "B".

Më datën 05.12.2025, në ora 13:30 kemi pas humbje të komunikimit me kontrollerat e kogjenerimit, përfshirë sistemin e mbajtjes së presionit të kogjenerimit, me përjashtim të kontrollerit, që përfshin pompat qarkulluese të distribuimit. Prandaj, pompat qarkulluese të rrjetit ishin në punë ndërsa ato të kogjenerimit janë ndalur, mirëpo pas shumë përpjekjeve kemi arritur që t'a kthejmë sistemin në punë, duke rikthyer komunikimin në funksion.

Në stacionin në HES, janë izoluar disa fije përcuesish të dëmtuar ndër vite nga brejtësit.

Është intervenuar në ndriçim tek zyra e arkivës, ndërimi i 1 panel led në dhomën e kontrollit dhe 1 paneli në korridorin tek zyret e inxhinierëve.

Më datën 11 dhjetor i kemi asistuar divizionit PKU në marrjen e mostrës nga analizatori i PKU-së dhe funksionalizimin e sistemit.

Pastrimi i inverterëve Vfd të mbajtjes së presionit dhe atij të filtrit magnetik.



*Tabela 15. Aktivitetet e Divizionit të elektrikës gjatë periudhës raportuese tetor-dhjetor 2025*

Energjia elektrike TM4/2025						
Muaji	Ngrohtore (MWh)	Ngrohtore (€)	Nënstacione (MWh)	Nënstacione (€)	Total MWh	Total (€)
Tetor	671.10	121,885.10	260.79	50,646.52	<b>931.89</b>	<b>172,531.62</b>
Nëntor	911.40	150,308.54	348.82	61,985.40	<b>1,260.22</b>	<b>212,293.94</b>
Dhjetor	1,185.60	213,734.88	360.43	69,375.32	<b>1,546.03</b>	<b>283,110.20</b>

Total TM4/2025	2,768.10	485,928.52	970.04	182,007.24	3,738.14	667,935.76
----------------	----------	------------	--------	------------	----------	------------



## RAPORTI I PUNËVE TË REALIZUARA SIPAS PLANIT AKSIONAL 2025 TË PRODHIM/KOGJENËRIMIT

### Divizioni i PKU-së

Punët dhe aktivitetet kryesore, të cilat janë kryer në tremujorin e katërt 2025, mund t'i përmbledhim, si në vijim:

Gjatë periudhës raportuese tetor-dhjetor 2025, Divizioni i PKU-së, ka vazhduar realizimin e objektivave të saj në kordinim edhe me divizionet tjera me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë.

- Gjatë periudhës TM4-2025, PKU ka vazhduar deri kah mesi i dhjetorit të ballafaqohet me sfidat e njëjta për shkak të problemeve teknike në sistemin e zbutjes së ujit të dedikuar për furnizim me ujë kimikisht të përgatitur në rrjetin e kogjenerimit, pasi që edhe gjatë këtyre muajve kemi operuar vetëm me njërin zbutës të ujit, zbutësin nr 1, sepse zbutësi nr 2 ka qenë jashtë funksionit për shkak të problemeve teknike. Në fillim të dhjetorit është realizuar servisimi/riparimi i zbutësve dhe tani më janë funksional. Por, mund të konstatohet, se gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur probleme me furnizim me ujë kimikisht të përgatitur. Të dhënat statistikore të përgatitjes kimike të ujit të zbutur janë dhënë në tabelën e mëposhtme.
- Gjatë kësaj periudhe kohore janë përcjellë vlerat e fortësisë së ujit vazhdimisht çdo 24 orë dhe janë paraqitur në tabelën përkatëse në këtë raport.
- Po ashtu, PKU i është përgjigjur të gjitha kërkesave nga termonënstacionet për pastrim kimik të këmbyesëve të nxehtësisë.

**Tabela 16. Përgatitja kimike e ujit të zbutur gjatë periudhës tetor-dhjetor 2025**

Data	Ujë i futur në rrjet të distribuimit	Uji i përgatitur (sist. i vj.)	Uji i përgatitur (kogj)	Gjithsej ujë i përgatitur	Shpenzimi i kripës
	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	kg
Tetor	11241	11885	1	11886	11200
Nëntor	11848	11387	291	11678	10325
Dhjetor	12221	11452	273	11725	12400
<i>Mesatarja</i>	<i>11770</i>	<i>11574</i>	<i>188.33</i>	<i>11763</i>	<i>11308</i>
Gjithsej	<b>35310</b>	<b>34724</b>	<b>565</b>	<b>35289</b>	<b>33925</b>

**Tabela 17. Pastrimi kimik i këmbyesëve të nxehtësisë sipas kërkesave të termonënstacioneve të distribuimit:**

Nr	Datë	Rajoni	Adresa e nënstacionit	Nr. i këmbyesëve
1	15.12.2025	Dardania	Kurrizi 2	1
2	24.12.2025	Ulpiana	E 31	1
			Gjithsej:	2




Në TM4/2025 janë instaluar 101.2 metër gyp me paraizolim dhe 356 metër gyp çeliku.

Instalimi i gypave metër gjatësi në tetor-dhjetor 2025:

# 457.2m'

Figura 6. Instalimi i gypave të paraizoluara dhe të çelikut



## DEPARTAMENTI I DISTRIBUIMIT

### Aktivitetet e Departamentit të distribuimit

Gjatë periudhës tetor-dhjetor, Departamenti i distribuimit ka pasur këto aktivitete:

Intervenimet në sistemin primar të ngrohjes

- Instalimi i gypave;
- Instalimi i kthesave;
- Instalimi i valvolave;
- Instalimi i filtrave;
- Instalimi i pompave;
- Pastrimi i këmbysesëve

Intervenimet në sistemin sekondar të ngrohjes:

Instalimi i matësve të energjisë  
Kuçjet e reja;  
Puna me palë të treta;  
Raportimi mbi humbjet e ujit dhe energjinë termike, dhe aktivitetet tjera.

### Instalimi i gypave

Gjatë periudhës raportuese janë instaluar 457.2 metër gyp, prej të cilave 101.2m gyp me paraizolim dhe 356 m gyp çeliku.

Tabela 18. Pasqyra përmbledhëse e aktiviteteve të Departamentit të distribuimit gjatë TM4/2025

nr	Aktiviteti	Totali	Njësia
1	Intervenimet në rrjetin primar të ngrohjes		intervenime
2	Intervenimet në rrjetin sekondar të ngrohjes		intervenime
3	Instalimi i gypave të paraizoluara & të çelikut	457.2	m'
4	Instalimi i kthesave paraizoluara & të çelikut	23	copë
5	Instalimi i këmbysesëve të nxehtësisë	1	copë
6	Instalimi i valvolave të ngrohjes	3	copë
7	Instalimi i pompave qarkulluese	9	copë
8	Instalimi i filtrave		copë
9	Instalimi i matësve të energjisë		copë

Tabela 19. Instalimi i gypave tetor-dhjetor 2025

Nr.	Dim. i gypit	Realiz.	Vërejtje
1	DN32	284	Prej të cilave 6m gyp me paraizolim
2	DN40	6	Gypa me paraizolim
3	DN50	126	Prej të cilave 60m gyp me paraizolim
4	DN65	20	Prej të cilave 8m gyp çeliku
5	DN125	20	Gypa me paraizolim
6	DN150	1.2	Gypa me paraizolim
TOTAL		457.2	

### Instalimi i kthesave

Në periudhën raportuese tetor-dhjetor 2025 janë instaluar gjithsej 16 kthesa çeliku dhe 7 kthesa me paraizolim.

Tabela 20. Instalimi i kthesave

Nr.	Dim. i gypit	Realizimi	Vërejtje
1	DN32	16	Kthesa çeliku
2	DN50	1	Kthesa me paraizolim
3	DN100	6	Kthesa me paraizolim
TOTAL		23	


### Instalimi i filtrave

Tabela 21. Instalimi dhe pastrimi i filtrave

Nr.	Dim. i filtrit	Realizimi	Vërejtje
1	-	-	-
TOTAL		-	



Figura 7. Paraqitja grafike e instalimit të kthesave, valvolave, pompave, filtrave, këmbyesëve dhe matësve të energjisë



## INSTALIMI I POMPAVE, VALVOLAVE, FILTRAVE, KËMBYESËVE DHE MATËSVE TË NXEHTËSISË

### Instalimi i pompave

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2025, janë instaluar 9 pompa.

Tabela 22. Instalimi i pompave

Nr.	Dim. pomp	Realizimi	Vërejtje
1	DN25	1	
2	DN40	2	
3	DN50	4	
4	DN65	2	
TOTAL		9	Copë

### Instalimi i valvolave

Janë instaluar gjithsej 3 valvola të dimensioneve të ndryshme.

Tabela 23. Instalimi i valvolave

Nr.	Dim. i valv.	Realizimi	Vërejtje
1	DN100	3	Nënstacion, pusëtë
TOTAL		3	Copë

### Këmbyesit e nxehtësisë

Në TM4/2025 është instaluar një këmbyes i nxehtësisë

Tabela 24. Instalimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Nr.	Lloji dhe fuqia	Realizimi	Vërejtje
1	800kW	1	Nënstacion
TOTAL		1	

### Pastrimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Tabela 25. Pastrimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Nr.	Adresa	Realizimi	Vërejtje
1			
TOTAL		-	

### Intervenimet në pjesën sekondare

Tabela 26. Intervenimet urgjente në pjesën sekondare

Nr.	Rajoni	Adresa	Interven.	Pershkrimi i punëve
1				

### Matësit e nxehtësisë

Gjatë periudhës raportuese, s'ka instalim të matësve të nxehtësisë.

Tabela 27. Matësit e energjisë

Nr.	Rajoni	Adresa	Lloji	Realiz.	Data
-----	--------	--------	-------	---------	------

1			
---	--	--	--

### Kyçjet ilegale dhe pa proces- të identifikuara

Tabela 28. Kyçjet ilegale dhe pa proces të identifikuara gjatë TM4/ 2025:

Nr.	Nr kons.	Vërejtje
1	51	adresa të ndrysh
2	14	adresa të ndrysh
3	1	Rr.Bulevardi Nën
4	26	adresa të ndrysh
5	6	adresa të ndrysh
6	5	adresa të ndrysh
7	10	adresa te ndrysh
8	1	Kroi i Bardhë, Ue Lokal
TOTAL	114	

### Kyçje, rikyçjet dhe shkyçjet me ofertë në rrjetin sekondar

Tabela 29. Kyçjet, rikyçjet dhe shkyçjet me ofertë në rrjetin sekondar të ngrohjes gjatë TM4/ 2025:

Nr.	Adresa	Sip. m2	Vërejtje
1	Rr. Nikë Prela, nr. 100	106.24	Shkyçje
2	Su-5/L-3, Nr.35	62.31	Shkyçje
3	Ilaz Kodra Lam D, Lokali Nr.1	100.22	Shkyçje
4	Ilaz Kodra Lam D, Lokali Nr.1	66.31	Shkyçje
5	Su-9/1, Hy 5. Nr.2A		Shkyçje
6	Vendbanimi B-1 P-5 nr.10	50.51	Shkyçje
7	Brigadat e Kosovës H/16 nr.4	50.51	Shkyçje
		436.1	

### Rikthim i sipërfaqes ngrohëse

Tabela 30. Rikthimi i sipërfaqes ngrohëse gjatë periudhës TM4/2025

Nr.	Adresa	Sipërfaqja m2	Vërejtje
1	Rr.Fehmi Agani	24	

### Kyçjet e reja

Tabela 31. Kyçjet e reja në rrjetin primar gjatë periudhës TM4/2025



Nr.	Adresa	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Zvlerë	Shënime
1	Rr. Filip Shiroka, nr. 11	350		Kyçje e re






Faturimi në TM4/2025 është, 171,253 euro më i vogël se në TM4/2024.

Rënia e faturimit krahasuar me tremujorin e vitit paraprak, shprehur në përqindje

**-3,6%**



## DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT

### Aktivitetet e Departamentit të furnizimit gjatë periudhës tetor-dhjetor 2025

Në bazë të planit për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet është përgatitur plani i aktiviteteve operacionale për arkëtim të borxheve të vjetra. Faturimi në periudhën raportuese tetor-dhjetor 2025 është si në vijim.

Tabela 32. Faturimi në TM4/ 2025, krahasimi me TM4/ 2024:

Periudha	TM4/2024	TM4/2025	Eval. €	Eval. %
Total faturimi	4,714,181 €	4,542,928 €	-171,253 €	-3.63%


Ndërsa, të hyrat e përgjithshme nga arkëtimi i mjeteve në periudhën tetor-dhjetor 2025 janë si vijon:

Tabela 33. Inkasimi në TM4/2025, krahasimi me TM4/2024:

Periudha	TM4/2024	TM4/2025	Eval. €	Eval. %
Amvisëri	1,456,159 €	1,342,736 €	-123,424 €	-8%
Afarist/institut.	695,016 €	825,369 €	130,353 €	19%
Total inkasimi	2,161,175 €	2,168,104 €	6,930 €	0.3%

Në vazhdim në mënyrë grafike paraqesim të dhënat e inkasimit për periudhën raportuese tetor-dhjetor 2025 si dhe krahasimin me tetor-dhjetor 2024.

Figura 8. inkasimi në TM4/2025, krahasimi me TM4/2024:



Të hyrat nga arkëtimi i mjeteve për periudhën TM4/ 2025 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë 0.3% më të mëdha, shprehur në vlerë monetare 6,930€.

### Raporti i ankesave dhe kërkesave gjatë periudhës raportuese tetor-dhjetor 2025

Në vijim në mënyrë të përbledhur në formë tabelare paraqesim raportin mbi ankesat dhe kërkesat gjatë TM4/2025.

Tabela 34. Raporti mbi ankesat dhe kërkesat gjatë periudhës raportuese TM4/ 2025.

Muaji	Ankesa të pranuar	Përgjigjet në ankesa	Kërkesa të pranuar	Përgjigjet në kërkesa
Tetor	123	169	487	114
Nëntor	51	85	175	291
Dhjetor	271	158	245	209
Total	445	412	907	614

Sqarim: Janë përfshirë përgjigjet edhe për ankesa dhe kërkesa të bartura nga viti paraprak.

### Kontratat për furnizim me ngrohje

Në periudhën raportuese TM4/ 2025, janë nënshkruar gjithësej 405 kontrata për furnizim me ngrohje me konsumatorë. Prej të cilave 342 kontrata nga sektori i amvisërisë dhe 63 nga sektori afarist.

Tabela 35. Kontratat për furnizim të nënshkruara gjatë periudhës raportuese TM4/ 2025.

Muaji	Kontrata për furnizim me ngrohje-baneror	Kontrata për furnizim me ngrohje-biznesor	Gjithsejt kontrata të nënshkruara
Tetor	134	19	153
Nëntor	123	23	146
Dhjetor	85	21	106
Total	342	63	405



## DEPARTAMENTI I FURNIZIMIT



Krahasuar me TM4 të vitit paraprak 2024, në fund të periudhës TM4/2025, kemi rritje të numrit të konsumatorëve 482 konsumatorë më shumë dhe kemi rritje të sipërfaqes ngrohëse për 68,685 m<sup>2</sup>

Rritje e sipërfaqes ngrohëse prej

# 3.1%


### Numri aktual i konsumatorëve

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve aktiv në fund të periudhës raportuese është 25,597 konsumatorë. Ndërsa, në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i konsumatorëve aktiv ishte 25,115. Pra, kemi rritje të numrit të konsumatorëve aktiv prej 3.1%

### Sipërfaqja ngrohëse

Në fund të periudhës raportuese 2025, sipërfaqja ngrohëse aktive është 2,283,710.13m<sup>2</sup>. Ndërsa, në fund të vitit 2024, sipërfaqja ngrohëse aktive ishte 2,215,025 m<sup>2</sup>.

Figura 9. Sipërfaqja ngrohëse në TM4/2025, krahasimi me TM4/2024



### Kyçjet e reja

Në periudhën raportuese TM4/ 2025, në sistemin e ngrohjes qendrore "Termokos", janë kyçur gjithësej 134 konsumatorë të rinjë me sipërfaqe prej 9,504.68 m<sup>2</sup>.

Tabela 36. Konsumatorë të rinj - Kyçje të reja në TM4/ 2025

Sektor	Numri i konsumatorëve	Sipërfaqja m <sup>2</sup>
Amvisëri	130	9,240.5 m <sup>2</sup>
Afarist/institucional	4	264.18 m <sup>2</sup>
Total	134	9,504.68 m <sup>2</sup>

## DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM DHE INVESTIME KAPITALE

### NJËSIA PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE

Gjatë tremujorit tetor- dhjetor 2025, Departamenti për zhvillim dhe investime kapitale ka zhvilluar aktivitetet e tij në kuadër të dy projekteve strategjike të ndërmarrjes:

1. Projekti “Solar4Kosovo II- Solar District Heating”, financuar nga KfW, EBRD, WBIF dhe burime vendore;
2. Projekti për dyfishimin e kapaciteteve të kogjenerimit dhe rrjetit të transmetimit nga 140 MWth në 280 MWth, financuar nga EIB, BE dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe janë shënuar përparime të rëndësishme në konsolidimin e dokumentacionit teknik, mjedisor dhe social, avancimin e proceseve të shpronësimit, finalizimin e raporteve të konsulentëve dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderimit.

#### Projekti “Solar4Kosovo II – Solar District Heating”

Komponentet kryesore të projektit:

- Impianti diellor për ujë të ngrohtë (financuar nga KfW/WBIF);
- Rezervuari sezonal PTES dhe pompa termike me absorpcion (AHP);
- Tubacionet e lidhjes (Koridori A dhe Koridori B – financuar nga BERZH);
- Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes në lagjet e reja të Prishtinës.

Objektivat kryesore:

- Dekarbonizimi i sistemit të ngrohjes në Prishtinë;
- Ofrimi i ngrohjes nga burime të ripërtëritshme për lagjet urbane;
- Kursim vjetor i CO<sub>2</sub>: rreth 47.000 ton/vit;
- Prodhim vjetor i energjisë nga BRE: 43 GWh/vit.

Statusi i projektit:

- Koncept dizajni i përfunduar për PTES dhe impiantin diellor;
- Është finalizuar raporti mbi sigurinë e digës dhe dizajni teknik i ndërtesës energjetike. I njëjti është analizuar nga paneli i ekspertëve dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme për dosjen e tenderit dhe kontraktorin e ardhshëm;
- U dakordua kapaciteti i pompës termike me absorpcion 20 MW;
- Dizajni i sistemit të kolektorëve diellorë dhe ndërtesës teknike është përfunduar;
- Është përfunduar strategjia e komunikimit dhe dukshmërisë (C&V) –faqja zyrtare [www.solar4kosovo2.org](http://www.solar4kosovo2.org) dhe u shpërnda newsletter-i i parë;
- Dokumentet ESIA, ESMP, SEP dhe LALRP janë përditësuar dhe dërguar për No Objection tek donatorët;
- Master Plani për zgjerim është aprovuar dhe prezantuar publikisht para qytetarëve;
- Elabortet e shpronësimit për koridorin A janë përfunduar dhe dorëzuar në MMPHI. Për Koridorin B është nënshkruar Marrëveshja e mirëkuptimit për

përdorimin e korridorit rrugor. Koridori B mbetet të përgatitet elaborati i shpronësimit në dakordim me Komunën e Obiliqit;

- Janë organizuar takime koordinuese të përbashkëta me “Termokos” KfW dhe BERZH dhe konsulentin IC/CES.

Aktivitetet gjatë tremujorit (TM4 2025)

Gjatë periudhës tetor- dhjetor 2025 janë zhvilluar një sërë aktivitetesh teknike, administrative dhe pjesëmarrje e rregullt në takimet dyjavore koordinuese me konsulentin implementues (IC/CES) dhe Njësinë për zbatimin e projekteve (NJZP), me qëllim të shqyrtimit të progresit teknik dhe harmonizimit të dokumenteve projektuale.

- Mbatje e takimeve të progresit me përfaqësues të KfW dhe BERZH, ku janë diskutuar ecuria e përgjithshme e projektit, përgatitja e dizajneve teknike, rezultatet e fazës së para-kualifikimit dhe hapat e mëtejshëm për përgatitjen e tenderit për Lot 1;
- Takime ndërinstucionale me Komunën e Prishtinës dhe Drejtorinë e kadastrit lidhur me procesin e shpronësimit të tokës për stacionin e pompës përforcuese, si dhe rishikimin e parcelave alternative;
- Takime koordinuese me BERZH, “Termokos”, CES dhe Enova për rikategorizimin e projektit dhe përshtatjen e dokumenteve të ndikimit mjedisor dhe social (ESIA/ESMP);
- Koordinim i vazhdueshëm me konsulentët FOPIP/ESAP (Aspiro, Enova) për përgatitjen e raportit nismëtar/diagnostik dhe zhvillimin e intervistave me departamentet përkatëse të “Termokos”-it;
- Finalizimi dhe publikimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP) në faqen zyrtare të “Termokos”-it, si dhe përditësimi i dokumenteve LALRP/LAP/LRP;
- Nënshkrim i kontratës për Panelin e ekspertëve të pavarur për sigurinë e digave (PoE), zhvillimi i takimeve përkatëse dhe pranimit të raportit të parë të gjetjeve, i cili është integruar në procesin e përgatitjes së dokumenteve të tenderit;
- Zhvillim i planifikimit të sistemit SCADA dhe definimi i kërkesave teknike për integrimin e sistemeve të kontrollit, në koordinim me departamentet përkatëse dhe konsulentin implementues;
- Komunikimi dhe koordinimi i vazhdueshëm me institucionet financiare ndërkombëtare (IFI), konsulentët dhe autoritetet qeveritare lidhur me procedurat e tenderimit, aprovimet teknike dhe çështjet rregullative;
- Përditësimi i Master planit të zgjerimit dhe përcaktimi i prioritetëve për zonat “Lakrishte”, “Kalabria”, “Tophane”, “Mahalla e Muhaxherëve” dhe “Qyteti i vjetër”, përfshirë simulimet hidraulike dhe verifikimin e kapaciteteve të rrjetit ekzistues;
- Vazhdimi i nënshkrimit të parakontratave me objektet, që planifikohen të kyçen në rrjetin e ngrohjes qendrore, me qëllim të ruajtjes së projeksioneve të konsumit dhe stabilitetit të planifikimit;
- Përgatitje e udhëzuesit të brendshëm për komunikim dhe dukshmëri (C&V manual) dhe organizimi i trajnimeve për stafin e “Termokos”-it për zbatimin e tij;
- Dorëzimi i elaboratit të shpronësimit për Koridorin A në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe iniciimi i procedurave për Koridorin B, përfshirë nënshkrimin e Marrëveshjes së mirëkuptimit për përdorimin e korridorit rrugor;
- Ndjekje e procedurave të para-kualifikimit për Lot 1, përgatitja e komenteve të PIU/NJZP dhe koordinimi për rishpalljen dhe finalizimin e dosjes së tenderit;
- Miratim përfundimtar i raportit tremujor QR6 nga “Termokos” dhe KfW, si dhe aprovimi i faturave përkatëse të konsulentit implementues;
- Dorëzimi i paketave kryesore të FOPIP-it, Planit të Zhvillimit Korporativ (CDP) dhe Planit të Integruar të Menaxhimit të Aseteve, si bazë për forcimin e performancës financiare dhe operative të ndërmarrjes;
- Përgatitje për publikimin e dokumentit ESIA dhe koordinim i aktivitetëve të konsultimit publik në përputhje me kërkesat e donatorëve dhe legjislacionit vendor.

#### Sfidat:

- Zvarritje në procesin e shpronësimit për Koridorin B dhe lokacionin e varrezave;
- Mungesë e konfirmimeve për lejet mjedisore dhe kyçjen në sistemin e ujësjellësit;
- Vonesë në procedurën e parakualifikimit (PQ) për Lot 1 (rishpallja në tetor 2025 me shtyrje të aftit për dorëzim për 30 ditë shtesë, deri më 15 janar 2026);
- Nevoja për mirëkordinim ndërmjet institucioneve lokale dhe donatorëve për përshpejtimin e vendimmarrjes administrative.

#### Raportimi financiar

Përshkrimi	Vlera (EUR)
Lot 1 – Impianti solar me PTES, AHP dhe ndërtesë teknike	55,723,675
Lot 2 – Komponentët e rrjetit dhe integrimi	16,857,595
Shpronësim, projektim dhe mbikëqyrje	5,189,322
Totali CAPEX	77,770,592
Kontigjenca (12%)	9,332,471
Totali i përgjithshëm i investimit	87,103,063

#### Burimet e financimit:

- WBIF Grant: 21,500,000 €
- Kredi KfW: 31,600,000 €
- Kredi EBRD: 18,900,000 €
- Kontributi vetanak: 15,103,063 €

#### Projekti për dyfishimin e kapaciteteve të kogjenerimit (EIB Project – ERI/ITA)

##### Përshkrimi

Projekti parashikon dyfishimin e kapacitetit të ngrohjes nga 140 MWth në 280 MWth, përfshirë ndërtimin e linjës së tretë të transmetimit dhe nënstationeve të reja HES2/HRS2. Financimi është planifikuar nga EIB (krediti), IPA Grant dhe Qeveria e Kosovës.

##### Objektivat dhe përfitimet:

- Rritja e efikasitetit të energjisë dhe sigurisë në furnizim;
- Zëvendësimi i ngrohjes individuale me ngrohje qendrore;
- Ulje neto e emetimeve të CO<sub>2</sub> me rreth 97,447 ton/vit;
- Kontribut në dekarbonizimin e sistemit të ngrohjes deri në vitin 2050.

##### Statusi aktual:

- Dokumentet bazë të përfunduara: Plani i angazhimit të palëve të interesit, Analiza ekonomiko-financiare, Vlerësimi i ndikimit mjedisor, Plani i implementimit, Strategjia e prokurimit dhe Master plani i zgjerimit, Strategjia e dekarbonizimit, Specifikimi teknik i projektit për HES, gypin e transmisionit dhe HRS;
- Në proces: finalizimi i Elaboratit të shpronësimit për trasenë nga KEK deri tek "Termokos";

- Dokumenti i tenderit para finalizimit;
- Vonesa në sigurimin e fondeve për shkak të masave të BE-së ndaj Kosovës.

#### Raportimi financiar (EIB Project)

Komponenta	CAPEX (€)
1. Prodhimi dhe transmetimi (CHP, ura, stacionet HES/HRS, gypat DN800)	32,410,681
2. Rrjeti i ngrohjes- zgjerim sipas Master planit	28,016,280
3. Dizajn, sigurime dhe përkrahje inxhinierike	2,945,000
Totali i projektit	63,371,961

#### Burimet e financimit:

- EIB Kredi: 31,685,981 €;
- IPA Grant: 17,600,000 €;
- Qeveria e Kosovës: 9,000,000 €;
- Kontributi i "Termokos": 5,085,981 €.

#### Sfidat kryesore:

- Sigurimi i fondeve nga BE për shkak të situatës politike;
- Finalizimi i procesit të shpronësimit;
- Marrja e lejeve nga autoritetet komunale dhe qendrore.

#### Aktivitetet e përgjithshme të DZHK gjatë tremujorit:

- Koordinimi me EU, EIB dhe donatorë të tjerë për progresin e projekteve;
- Financimi i projektit është aprovuar përfundimisht nga Bordi i Bankës Evropiane për Investime (EIB);
- Sigurimi i grantit nga BE pas zbutjes së masave nga Bashkimi Evropian;
- Vizita e delagacionit të lartë nga BE;
- Përgatitja dhe dërgimi i informacionit për raportet mujore dhe tremujore;
- Zhvillimi i takimeve me MMPHI për procesin e shpronësimit të parcelave dhe verifikimin e pronësisë;
- Koordinimi me sektorët e tjerë të ndërmarrjes për integrimin e të dhënave teknike dhe financiare;
- Përgatitja e materialeve prezantuese për takimet me IFI-të dhe menaxhmentin;
- Bashkëpunim i ngushtë me kompaninë konsulente në përgatitjen e tenderit për punë dhe konsulencë.

#### PËRFUNDIM

- Projekti "Solar4Kosovo II" është në fazën përfundimtare për tender, me pritje për parakualifikim në tetor 2025. Aplikacionet pritet të dorëzohen në janar 2026;
- Projekti EIB – Dyfishimi i kapaciteteve të kogjenerimit është në fazën e përfundimit të dokumentacionit dhe pritjes së financimit të plotë nga BE dhe Qeveria me nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare të financimit dhe ratifikimit në Parlamentin e Kosovës;
- Sfidat mbeten të lidhura kryesisht me proceset e shpronësimit, lejeve mjedisore dhe vonesave burokratike;
- Departamenti për zhvillim dhe investime kapitale rekomandon vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë me IFI-të dhe institucionet qeveritare për të siguruar zbatimin në afat të projekteve strategjike.



## TË ARRITURAT

Në TM4/ 2025, krahasuar me TM4/ 2024 është arritur:

- Rritje e inkasimit 0.32 %;
- Rritje e numrit të konsumatorëve 1.9%;
- Rritje e sipërfaqes ngrohëse 3.1%;
- Përparim në konsolidimin e departamenteve të reja;
- Progres në realizimin e Projekteve për zgjerim të rrjetit;
- Ngritja e shkallës së qëndrueshmërisë afariste të ndërmarrjes.

## SFIDAT

Gjatë punës tetor-dhjetor 2025 sfidat më të mëdha kanë qenë:

- Ngritja e inkasimit;
- Arkëtimi i borxheve të vjetra të trashëguara;
- Ngritja e çmimeve, gjë e cila ka ndikuar në realizimin e projekteve ekzistuese dhe fillimin e projekteve të reja;
- Implementimi i rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
- Procedurat e brendshme të departamenteve.

## OBJEKTIVAT

Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ngrohjes së qëndrueshme dhe kualitative për konsumatorët ekzistues dhe ata që do kyçen;

- Realizimi i projekteve tjera në kuadër të Projektit të Koogjenerimit.
- Vazhdimi i reformimit të shërbimeve të administratës;
- Ngritja e nivelit të kontrollit të brendshëm;
- Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të rrjetit të ngrohjes;
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit konform Masterplanit;
- Instalimi i njehsorëve digjital për konsumatorët e sektorit të amvisërisë;
- Fillimi i faturimit të konsumatorëve banesorë bazuar në energjinë e shpenzuar;
- Intensifikimi i bashkëpunimit me organet komunale dhe qendrore.

## MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË NDËRMARRJES

Me qëllim të realizimit të objektivave të saj gjatë vitit 2025, siç janë qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjes, ofrimi i ngrohjes më kualitative për qytetarët, reformimi dhe modernizimi i administratës, rritja e arkëtimit përfshirë edhe borxhet, realizimi i Projektit të Kogjenerimit e tjera, janë paraparë këto masa:

- Ulja e mëtutjeshme e shpenzimeve operacionale;
- Kompletimi i akteve të brendshme administrative;
- Rehabilitimi teknik i rrjetit të distribuimit dhe njësisë së prodhimit;
- Zbatimi i masave operacionale për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet;
- Intensifikimi i punëve në realizimin e Projektit të Kogjenerimit.

u.d. Kryeshef Ekzekutiv

Kastriot Blaca

